
RR 768 638 081 AA

Ymeri dtl.25.12.2016 dhe Emanuel Ymeri dtl.24.09.2018 të ardhur gjatë bashkëjetesës të palëve ndërgjyqëse. Caktimin e përgjegjësisë prindërore për rritje dhe edukim për të tre fëmijët e mitur paditësit në këtë gjykim babait të tyre.

2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Kundër ketij vendimi lejohet ankim i veçante në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar të gjykatës.

Korçë, më 28.01.2025, ora 13.06.

SEKRETARE
XHORXHINA VANGJEL

GJYQTARE
DORINELA NIKOLLI

VËREN :

Se, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë me kërkesë padi me objekt;
"Zgjidhjen e pasojave juridike nga ndërprerja e bashkëjetesës lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për 3 (tre) fëmijët Luis Ymeri dtl.28.07.2015, Kristjan Ymeri dtl.25.12.2016 dhe Emanuel Ymeri dtl.24.09.2018 të ardhur gjatë bashkëjetesës të palëve ndërgjyqëse. Caktimin e përgjegjësisë prindërore për rritje dhe edukim për të tre fëmijët e mitur paditësit në këtë gjykim babait të tyre".

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe prova të kërkesë padisë, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështjeje. Në bazë të Neneve 36/1, 41, 42, 48, 59 të K. Pr. Civile, gjykata pasi shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kompetencen e saj lëndore e tokësore, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil, dhe është në kompetencën e saj lëndore e tokësore.

Nga verifikimi si dhe në zbatim të nenit 174/1 të Kodit të Proçedurës Civile i cili parashikon se *"Në ditën dhe në orën e caktuar palët ose përfaqësuesit e tyre janë të detyruar që të njoftojnë gjykatën për praninë e tyre"*, gjykata konstatoi se pala paditëse dhe pala e paditur u paraqitën personalisht në seancë. Pas verifikimit të palëve, përfaqësuesja ligjore e palës paditëse i kërkoj gjykatës pushim e çështjes pasi ishte konsultuar me paditësin, dhe ai kërkon të heqë dorë nga padia. Pala paditëse u shpreh se kërkoj që kjo çështje të pushohet.
Pala e paditur u shpreh dakord me pushimin e çështjes.

Për sa më sipër Gjykata çmon se bazuar në Nenin 201 të K. Pr. Civile, *"Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes.*
Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të paditurit nuk ka shkak të ligjshëm".
Neni 299/b i K. Pr. Civile përcakton se: *"Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë";*

Nisur nga fakti se e drejta mbi disponimin e padisë i përket palës paditëse, gjykata çmon se kjo kërkesë e saj është e ligjshme, objektivisht e justifikuar dhe si e tillë duhet pranuar.

Në këto kushte gjykata e gjendur përpara këtij fakti referuar Neneve 201/1 dhe 299/b të K. Pr. Civile, çmon se çështja civile me Nr. 1014/2052 Regjistri Themeltar për shkaqet dhe bazën ligjore të sipërpërmendur, duhet pushuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 127, 201 dhe 299/b të Kodit të Proçedurës Civile,

VENDOSI :

1. Pushimin e gjykimit të çështjes civile me palë paditëse Edmond Ymeri, palë e paditur Denisa Selmani, me objekt Zgjidhjen e pasojave juridike nga ndërprerja e bashkëjetesës lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për 3 (tre) fëmijët Luis Ymeri dtl.28.07.2015, Kristjan

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PERGJITHSHËM KORÇË

Nr.1014/2052 (21001-01477-41-2024) Regj. Themeltar
Data e regjistrimit 11.11.2024.

Nr 41-2025-240 (57)Vendimi
Datë 28.01.2025.

VENDIM
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Korçë përbërë nga:

GJYQTARE - DORINELA NIKOLLI

Asistuar nga sekretare gjyqesore Xhorxhina Vangjel, sot më datë 28.01.2025, ora 12.52, mori në shqyrtim në seancë përgatitore çështjen civile me Nr. 1014/2052 akti që i përket palëve:

PADITËS: **Edmond Ymeri**, i biri i Emin dhe i Bajame, i datëlindjes 28.06.1976, banues në Korçë me adresë: lagjia nr. 9, Rr. "*Midhi Kostani*", (Përfitues i ndihmës juridike dytësore falas me vendim Gjykate), përfaqësuar nga Av. Elsa Haxhillari.

E PADITUR: **Denisa Selmani**, e bija e Pellumb dhe e Mirije, e datëlindjes 13.10.1990, banuese në fshatin Vashtemi, Korçë.

OBJEKTI: Zgjidhjen e pasojave juridike nga ndërprerja e bashkëjetesës lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për 3 (tre) fëmijët Luis Ymeri dtl.28.07.2015, Kristjan Ymeri dtl.25.12.2016 dhe Emanuel Ymeri dtl.24.09.2018 të ardhur gjatë bashkëjetesës të palëve ndërgjyqëse. Caktimin e përgjegjësisë prindërore për rritje dhe edukim për të tre fëmijët e mitur paditësit në këtë gjykim babait të tyre.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 227 të Kodit të Familjes, Ligji Nr.9359, datë 24.03.2005 "Për Ratifikimin e Konventës Europiane për Marrëdhëniet me Fëmijët". Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Gjykata pasi çeli seancën përgatitore të datës 28.01.2025, ora 12.52 të caktuar për shqyrtimin e kërkesë padisë dhe verifikoi në bazë të nenit 175/1 të Kodit të Procedurës Civile paraqitjen e palëve në proçes,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KORÇË

Korçë, më 19.03.2025

BASHKIA MA
Zyra e Protokolit
Nr. 1852 Prot.
Date 25.3.25 Nenshkrimi

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar : Bashkise Maliq

Për shtetasen : Denisa Selmani
Me adresë: Vashtemi Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 57 dt. 28.01.2025 për t'u afishuar nga ana juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi dëftesa e komunikimit është kthyer me shënimin : " e pakonfirmuar " dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Për Bashkine Maliq

_____
(emër, mbiemër, firmë)

ST IMP
dt 25.03.2025